



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 31.01.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë shkollës së magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 13:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. John Kastning, Drejtor i Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjzbatimit (EWMI-INL).*
- 5. Sarmela Titka, përfaqësuese (EWMI-INL).*
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 7. Tidita Fshazi, përfaqësuese e delegacionit të Bashkimit Evropian.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 9. Të tjerë: Petrika Thanu, gazetar (MCN-Press).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë shkollës së magistraturës, për vitin akademik 2023–2024”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 31 janar.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të merren në shqyrtim katër çështje. Çështja e parë, që është edhe çështja më e rëndësishme, ka të bëjë me përcaktimin nga ana e Këshillit të kuotave për vitin akademik 2023–2024.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e tre vendimmarrjeve për transferimin e gjyqtarëve, në kuadër të masave që kemi marrë për sa i përket zhbllokimit të situatës në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Çështja e tretë ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtarë të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022 – 2023.

Çështja e fundit, ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të gradimit, për periudhën 2013 – 2016, gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, të gjyqtarës {...} ku relatore do të jetë zonja Irena Plaku.

Pa humbur kohë fillojmë mbledhjen me çështjen e parë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi rendin e ditës.

Për çështjen e parë, fjalën ia jap kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Pa humbur kohë, unë sot përpara jush do prezantoj projektvendimin dhe relacionin që i bashkëngjitet këtij projektvendimi, me objekt: “Për përcaktimin e numrit të kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024”.

Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 29, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në janar të çdo viti, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të përcaktojë dhe publikojë numrin maksimal të kandidatëve magistratë (profili gjyqtar) që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik. Krahas kësaj, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 53, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të përcaktojë dhe publikojë edhe numrin maksimal të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që do të pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

Nisur nga këto detyrime ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet që, brenda muajit janar të vitit 2023, të përcaktojë numrin maksimal të: i) kandidatëve magistratë/profili gjyqtar; ii) kandidatëve për këshilltarë ligjorë; iii) kandidatëve për ndihmës ligjorë, që duhet të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin e ri akademik 2023 – 2024. Për këtë qëllim, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për numrin maksimal të kandidatëve profili gjyqtar, të kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që duhet të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin e ri akademik 2023 – 2024”.

Përpara parashtrimit të projektvendimit, është e rëndësishme që në këtë relacion të pasqyrohen treguesit dhe faktorët mbi të cilët është parashikuar numri përkatës maksimal i kandidatëve magistratë/profili gjyqtar, si dhe kandidatëve këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, që duhet të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për këtë vit akademik.

Këta tregues dhe faktorë lidhen me: i) situatën në të cilën ndodhet sistemi ynë gjyqësor; ii) ndikimin që ka në sistemin gjyqësor implementimi i reformës në drejtësi; iii) kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës në lidhje me ofrimin e formimit fillestar; iv) projeksioni/vizioni i Këshillit për sistemin gjyqësor në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Për numrin maksimal të kandidatëve magistratë/profili gjyqtar.

Vlerësimi i numrit maksimal të kandidatëve magistratë/profili gjyqtar, por jo vetëm, që duhet të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për vitin e ri akademik 2023 – 2024, bazohet në këto të dhëna që kemi përgatitur:

I) nevojat aktuale për gjyqtarë në sistemin gjyqësor, referuar për këtë numrit të vendeve vakante/pozicioneve të lira të përhershme;

II) nevojat e pritshme për gjyqtarë në sistemin gjyqësor deri në vitin 2026, referuar për këtë numrit të vendeve/pozicioneve në sistemin gjyqësor që pritet të bëhen të lira të përhershme deri në vitin 2026, kur diplomohen kandidatët magistratë që do të rekrutohen gjatë vitit të ri akademik 2023 – 2024;

III) nevojat aktuale dhe në vijimësi për gjyqtarë në institucionet e sistemit të drejtësisë;

IV) mundësitë e plotësimit të nevojave aktuale dhe atyre të pritshme në një të ardhme të afërt, referuar për këtë numrit të kandidatëve magjistratë që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës gjatë viteve 2023 – 2024 – 2025, pra gjatë viteve pararendëse me vitin 2026;

V) kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës.

Nevojat aktuale për gjyqtarë në sistemin gjyqësor:

Numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit (juridiksion i përgjithshëm dhe i posaçëm), i përcaktuar me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.7818, datë 16.11.2012, i ndryshuar më pas me Dekretin nr.9409, datë 27.01.2016 si dhe me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.286, datë 18.12.2019, referuar dhe numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, përcaktuar me ligjin nr.8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, është në total 408.

Shkalla e parë, juridiksioni i përgjithshëm: numri i përgjithshëm i gjyqtarëve është 235; Shkalla e parë administrative: numri i përgjithshëm i gjyqtarëve është 36; Gjykatat e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar: numri i përgjithshëm është 16. Në total, referuar shumatores së numrave të përmendura më lart, totali për gjyqtarët e shkallës së parë në Republikën e Shqipërisë është 287 gjyqtarë që duhet të ushtrojnë funksionet e tyre në gjykatat e shkallëve të para.

Gjykatat e apelit, juridiksioni i përgjithshëm është përcaktuar si numër 78; juridiksioni administrativ 13; juridiksioni i posaçëm penal (gjykata e apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar) 11 gjyqtarë. Totali 102 gjyqtarë.

Gjykata e Lartë ka gjithsej 19 gjyqtarë.

Pra totali i gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë është 408.

Ky numër është ligjërish në fuqi në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk ka marrë një vendim për numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë, referuar nenit 90 të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Aktualisht, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit, në sistemin gjyqësor ekzistojnë këto vende vakante/pozicione të lira të përhershme:

Në gjykatat e shkallës së parë janë 50 vende/pozicione të lira të përhershme (36 i përkasin vakancave të përhershme pjesë e juridiksionit të përgjithshëm (nga të cilat 22 pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë), 10 Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe 4 në juridiksionin e shkallës së parë administrative.

Në gjykatat e apelit, gjithsej, aktualisht rezultojnë të jenë të lira 38 vende/pozicione (33 prej tyre i përkasin juridiksionit të përgjithshëm në apel, 4 i përkasin apelit të juridiksionit administrativ dhe 1 i përket juridiksionit penal të apelit, pra Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar);

Në Gjykatën e Lartë – 3 vende/pozicione (që duhet të plotësohen nga radhët e gjyqtarëve – 2 në fushën administrative, 1 civile (dhe është shpallur 1 pozicion penal, për shkak të mbarimit të mandatit të një gjyqtari në Gjykatën e Lartë) të cilat janë aktualisht në proces për t'u plotësuar).

Aktualisht, në sistemin gjyqësor ekzistojnë 91 vende vakante/pozicione të lira të përhershme, që duhet të plotësohen përmes rekrutimit dhe ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Në numrin 91 të vende vakante/pozicione të lira të përhershme në sistemin gjyqësor nuk janë përfshirë, duke mos u konsideruar të lira, 19 pozicione, të cilat i mbajnë 2 gjyqtarë të pezulluar për shkak të proceseve penale që janë ngritur ndaj tyre, si dhe 17 gjyqtarë të zgjedhur apo të komanduar në institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë, për periudha afatmesme ose afatgjata, siç do të përmendet më poshtë.

Bashkëlidhur është edhe pasqyra.

Numri i gjyqtarëve të komanduar në Republikën e Shqipërisë është 19 në institucione të tjera, në Këshillin e Lartë Gjyqësor bëjnë pjesë 6 gjyqtarë, 2 gjyqtarë janë të pezulluar, 6 gjyqtarë janë me leje (4 leje dhe 2 të tjera janë leje të posaçme), janë të shkarkuar me vendim të KPK-së (si vakancë e përkohshme) 65 gjyqtarë, dhe totali i vakancave të përkohshme është 90.

Nevojat e pritshme për gjyqtarë në sistemin gjyqësor deri në vitin 2026:

Në një të ardhme të afërt, deri në vitin 2026, në sistemin gjyqësor do të krijohen vende

vakante/pozicione të lira të tjera të përhershme si rezultat i mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të:

a) Mbushjes së moshës 67 vjeç, të mbarimit të statusit të magjistratit (dalja në pension).

Për periudhën 2023 – 2026, numri i gjyqtarëve që mbushin moshën për mbarimin e statusit të magjistratit, në total është 20.

Sipas të dhënave të përditësuara nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të shtrira në këtë periudhë, ky numër është:

Në vitin 2023, rezultojnë 5 magjistratë (gjyqtarë) që mbushin moshën për pension pleqërie, nga të cilët 2 magjistratëve ju është pranuar kërkesa për qëndrim në detyrë deri në moshën 70 vjeç (4 janë në gjykatën e shkallës së parë dhe 1 i përket gjykatës së apelit).

Në vitin 2024, rezultojnë 2 magjistratë (gjyqtarë) që mbushin moshën për pension pleqërie (1 është gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe 1 është gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë).

Në vitin 2025, rezultojnë 7 magjistratë (gjyqtarë) që mbushin moshën për pension pleqërie (5 në gjykatat e shkallëve të para dhe 2 në gjykatat e apelit).

Në vitin 2026, rezultojnë 6 magjistratë (gjyqtarë) që mbushin moshën për pension pleqërie (5 në gjykatat e shkallëve të para dhe 1 në apel).

Në total për periudhën 2023 – 2026, rezultojnë 20 magjistratë (gjyqtarë) të cilët mbushin moshën për pension pleqërie. (bashkëlidhur Pasqyra që është pjesë e integruar e materialit të sotshëm).

b) Dorëheqjeve

Referuar të dhënave të përditësuara nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, përpara fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, kanë dhënë dorëheqjen nga detyra 3 gjyqtarë. Ndërsa gjatë rivlerësimit kanë dhënë dorëheqjen 58 gjyqtarë, sipas të dhënave si më poshtë:

Në vitin 2017 - 4 gjyqtarë; Në vitin 2018 - 3 gjyqtarë; Në vitin 2019 - 13 gjyqtarë; Në vitin 2020 -14 gjyqtarë; Në vitin 2021 – 14 gjyqtarë; Në vitin 2022 – 10 gjyqtarë.

Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore:

Në total për periudhën 2017 – 2022, rezultojnë 70 magjistratë (gjyqtarë) të cilët janë larguar nga sistemi, nga të cilët 58 magjistratë (gjyqtarë) kanë dhënë dorëheqjen nga funksioni dhe 12 magjistratë (gjyqtarë) janë larguar nga funksioni për shkak të mbushjes së moshës për pension pleqërie (bashkëlidhur është edhe Pasqyra nr.2 në materialin që kemi sjellë mbledhjen e sotshme).

Referuar shkaqeve të dorëheqjeve mund të supozohet se, për periudhën 2023–2026, numri i gjyqtarëve që mund të ndërpresin ushtrimin e funksionit me dorëheqje për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë (67 vjeç), në total është 20. Sipas të dhënave të përditësuara nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të shtrira në këtë periudhë, ky numër është:

Në vitin 2023 – 5 gjyqtarë; Në vitin 2024 – 2 gjyqtarë; Në vitin 2025 – 7 gjyqtarë; Në vitin 2026 – 6 gjyqtarë.

Potencialisht, fenomeni i dorëheqjes së gjyqtarëve mund të vazhdojë edhe në vijim, përgjatë periudhës së procesit të rivlerësimit kalimtar.

c) Shkarkimit nga detyra me vendim përfundimtar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prej muajit shkurt të vitit 2018 kur ka filluar veprimtarinë deri më datë 01.01.2023 ka dhënë këto vendime:

- ka konfirmuar në detyrë 132 gjyqtarë;
- ka shkarkuar nga detyra 126 gjyqtarë, nga të cilët 65 magjistratë (gjyqtarë) të shkarkuar nga KPK (të pezulluar dhe paguhen me 75% të pagës, pra është vakancë e përkohshme), duke përfshirë edhe një gjyqtar znj. {...}, e cila nuk është caktuar në organikën e ndonjë gjykate.
- ende nuk ka dhënë vendim për 63 gjyqtarë të cilët janë subjekt i rivlerësimit kalimtar (20 gjyqtar i përkasin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që do duhet t'i nënshtrohen procesit të vetting–ut pranë KPK–së dhe 10 gjyqtarë i përkasin Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë).

– 38 magjistratë në detyrë nuk janë aktualisht subjekt i ligjit 84/2016, dhe si të tillë ata janë verifikuar nga KLGJ-ja.

– 114 magjistratë janë të konfirmuar me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit.

Komisioneri publik, ndër këto vendime të cilat janë shpallur nga KPK-ja, ka ushtruar ankim ndaj vendimeve të konfirmimit në detyrë të 32 gjyqtarëve. Bashkëlidhur pasqyra 5.3.

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA-ja) ende nuk ka shqyrtuar 7 prej ankimeve të Komisionerit Publik.

Në 25 raste të shqyrtuara për 10 gjyqtarë të konfirmuar nga KPK-ja është vendosur shkarkimi nga detyra nga KPA-ja; në 14 raste të tjera është vendosur lënia në fuqi e vendimit të konfirmimit dhe në 1 rast është vendosur ndërprerje e procesit të rivlerësimit.

KPA-ja ka shqyrtuar 59 ankime të bëra nga magjistratët, nga të cilat ka lënë në fuqi 53, ka ndryshuar 5 vendime duke konfirmuar me vendim të formës së prerë magjistratët (4 prej këtyre vendimeve i përkasin vitit 2022) dhe ka prishur 1 vendim shkarkimi të KPK-së duke e rikthyer për rishqyrtim në KPK për të vijuar procesin, (bashkëlidhur Pasqyra nr.3/1).

Të shkarkuar nga detyra prej vitit 2018 deri më sot me vendim të formës së prerë, janë 63 gjyqtarë.

Në pritje për t'u shqyrtuar nga KPA-ja, janë ankimet e 63 gjyqtarëve të tjerë shkarkuar nga KPK-ja. Nga këto kolegji i posaçëm (KPA-ja) ende ka mbetur pa shqyrtuar 10 çështje të regjistruara në vitin 2020; 37 çështje me ankues magjistratë të shkarkuar të regjistruara në vitin 2021; 16 të regjistruara në vitin 2022;

Gjatë vitit 2022 KPA-ja ka dhënë vendime për 33 gjyqtarë; gjatë vitit 2021 KPA-ja ka dhënë vendime për 12 gjyqtarë dhe gjatë vitit 2020 për 11 gjyqtarë; (nuk përfshihen në këto shifra ankimet pas vendimit të KPK-së për të cilën më pas gjyqtarët kanë dhënë dorëheqje).

Nga ana tjetër, 2 gjyqtarë të shkarkuar nga KPK-ja janë në pritje të arsyetimit të

vendimit të Komisionit, për të vijuar më tej procesin e ankimimit ndaj këtyre vendimeve.

Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezultojnë:

– 132 magjistratë (gjqqtarë) të cilët janë konfirmuar nga KPK–ja, (bashkëlidhur Pasqyra nr.5)

– nga këta, rezultojnë 10 magjistratë (gjqqtarë) të cilët janë shkarkuar nga KPA–ja.

– 114 magjistratë (gjqqtarë) të cilët janë konfirmuar me vendim të formës së prerë.

– 32 magjistratë (gjqqtarë) të cilët janë konfirmuar nga KPK–ja dhe më pas ndaj këtyre vendimeve është ushtruar e drejta e ankimeve nga komisioneri publik në KPA.

Të dhënat e thëna më sipër nga ana ime janë të pasqyruara edhe në tabelën e integruar në këtë relacion.

Për të gjithë gjyqtarët e tjerë, ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar.

Duke pasur në konsideratë se sipas nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik përfundon në datën 31.12.2024, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit është 9 vjet. Si konkluzion, deri në këtë kohë, potencialisht, mund të përfundojë procesi i rivlerësimit kalimtar edhe për gjyqtarët e tjerë, duke iu referuar mandatit të komisionerëve publikë por edhe mandatit të anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Mandati i anëtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit është deri në datën 17 qershor 2026. Si rrjedhojë, në sistem do të përfshihen edhe 7 (shtatë) gjyqtarë në gjykatat e apelit të Republikës së Shqipërisë në qershor 2026, që janë anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Nisur nga të dhënat statistikore të procesit të rivlerësimit kalimtar në KPK, vetëm sa i përket vendimeve të konfirmimit dhe shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve, tendenca e deritanishme, pra deri më datë 16.01.2022, tregon se këtë vit, ka ndërruar lehtë tendenca dhe më shumë se gjysma e tyre, rreth 51,16 %, janë të konfirmuar në detyrë.

Kjo tendencë nëse konsiderohen të dhënat e KPA–së, rezulton sërish me një kurbë optimiste, duke konsideruar se për 5 gjyqtarë ka ndryshuar vendimi i KPK–së dhe

është vendosur konfirmimi në detyrë i gjyqtarëve, si edhe është vendosur lënia në fuqi e vendimit të KPK-së për 14 ankime të Komisionerit Publik.

Po ashtu, nisur nga të dhënat statistikore të procesit të rivlerësimit kalimtar në KPA, vetëm sa i përket vendimeve të lënies në fuqi dhe atyre të cenuara, gjithsej 83, tendenca e deritanishme, pra deri më datë 16.01.2022, tregon se në 81,93% të rasteve, KPA-ja ka lënë në fuqi vendimin e KPK-së, ndërsa në 18,07% të rasteve, KPA-ja ka cenuar vendimin e KPK-së.

Gjithashtu, mund të evidentohet se KPA-ja, nga 59 raste të vendimeve të shkarkimit nga detyra të KPK-së, vetëm në 5 raste apo 8,47% të rasteve totale, ka dhënë vendim në favor të konfirmimit në detyrë të gjyqtarit dhe në 1 rast e ka kthyer çështjen për rigjykim në KPK, apo në 1,7 % të rasteve totale.

Marrë në konsideratë kohëzgjatjen e deritanishme të shqyrtimit të çështjeve në KPA, deri në 24 – 36 muaj, numrit të rasteve që janë apo do të jenë patjetër për shqyrtim në KPA, gjithsej 73 raste (65 raste në shqyrtim të ankimuara nga vetë subjekti i rivlerësimit, 1 vendim shkarkimi që potencialisht do të ankimohet, si dhe 7 vendime konfirmimi të ankimuara nga komisioneri publik), si dhe tendencën e deritanishme të përfundimit të çështjeve në KPA, mund të supozohet se në një të ardhme të afërt, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve me vendim përfundimtar, në sistemin gjyqësor mund të krijohen 63 vende vakante/pozicione të lira të përhershme.

Gjithsesi, edhe mbi një parashikim optimist të tendencës së përfundimit të çështjeve në KPA, 50% me 50%, në një të ardhme të afërt, deri në vitin 2026, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve me vendim përfundimtar, në sistemin gjyqësor me shumë gjasë mund të krijohen 33 vende vakante/pozicione të lira të përhershme.

Duke marrë në konsideratë projeksionin e ndërmjetëm, midis përqindjes së sotme 81,93% të rasteve, lënien në fuqi të vendimeve të shkarkimit dhe projeksionin optimist 50% me 50%, pra duke marrë një projeksion të ndërmjetëm i cili shkon në 69.8%, mund të supozohet se në një të ardhme të afërt, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve me vendim përfundimtar, në sistemin gjyqësor mund të krijohen 44 vende vakante/pozicione të lira të përhershme.

Treguesit më lartë të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve vlejné për t'u mbajtur në konsideratë, në mënyrë që procesi aktual i rekrutimeve të mund të pakësojë pasojat negative në funksionimin e sistemit gjyqësor në një të ardhme të afërt, pra efektet që mund të vijnë nga ky proces gjatë tre viteve në vazhdim të mund të kapërcehen përmes rekrutimit të një numri të mjaftueshëm kandidatësh për magistratë, profili gjyqtar.

ç) Shkarkimit nga detyra në kuadër të përgjegjësisë disiplinore:

Deri më datë 16.01.2023, procedimet disiplinore që janë në shqyrtim ose të pezulluara pranë Këshillit, vetëm në një rast kërkohet shkarkimi nga detyra i gjyqtarit (procedim i cili është i pezulluar për shkak të pritjes së vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit).

Ndërkohë, nën procedim penal për kryerjen e një krimi janë edhe 2 gjyqtarë të tjerë, që mbajnë pozicionin në mënyrë të përhershme në sistemin gjyqësor.

Pra, sa më sipër, në një të ardhme të afërt, me siguri, në sistemin gjyqësor do të krijohen të paktën 2 vende vakante/pozicione të lira të përhershme.

Përfundime:

Sa më lart, referuar pikave të cilat unë i përmenda më lart ((a), (b), (c) dhe (ç)), ajo çka mund të supozohet aktualisht është se nevojat në një të ardhme të afërt në sistemin gjyqësor mund të jenë për 55 gjyqtarë. Ky konkluzion rezultoi nga shumatorja e 20 rasteve që ne i përmendëm më lart që i parashtruar si raste të mundshme të dorëheqjeve të gjyqtarëve, plus 44 është projeksioni ynë i rasteve që mund të krijohen vakanca të përhershme për shkak të vendimmarrjes që mund të sjellë Kolegji i Posaçëm i Apelit, si dhe 2 raste të tjera që mund të vijnë si rezultat i procedimeve penale ose procedimeve disiplinore. Në total, mund të themi se vende të lira, pra vakanca të përhershme deri në 2026 mund të krijohen në 66 pozicione ose vakanca të lira të përhershme.

Nevojat aktuale dhe në vijimësi për gjyqtarë në institucionet e sistemit të drejtësisë:

i) Anëtarët gjyqtarë të këshillit të lartë gjyqësor:

Aktualisht në Këshillin e Lartë Gjyqësor shërbejnë 6 gjyqtarë të zgjedhur nga të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor, për 3 nga të cilët mandati përfundon në dhjetor

2023, dhe në vend të tyre do të zgjidhen 3 anëtarët të rinj, ndërsa për 3 të tjerë mandati përfundon në dhjetor 2026.

Pra, referuar ligjit, në vijimësi, 6 gjyqtarë do të vijojnë të shërbejnë si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke mos ushtruar kështu funksionin në sistemin gjyqësor.

ii) Komandimi:

Neni 53 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se: “... 2. “Institucioni në të cilin magjistrati komandohet”, për pozicionin e ndihmësmagjistratit është Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit. 3. Me përjashtim të rasteve të caktimit në pozicion të sapoemëruarve, magjistratët mund të komandohen vetëm me pëlqimin e tyre. ...”

Duke përmendur institucionet e përmendura në nenin 53 të ligjit “Për statusin”, unë po vijoj referuar situatës aktuale në institucionet konkrete ku ne kemi komanduar aktualisht gjyqtarë.

a) Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se sipas organikës së këtij institucioni, numri i inspektorëve është 26, ku numri i atyre që vijnë nga radhët e magjistratëve, është 13. Gjatë vitit 2020 dhe në vijim, Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka paraqitur disa kërkesa për komandim të gjyqtarëve në pozicionin e inspektorit, ku në kërkesën e fundit është kërkuar komandimi i 6 gjyqtarëve. Pra, referuar ligjit, sipas organikës aktuale, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të duhet të ketë në vijimësi 6 gjyqtarë të komanduar. Mund të përmendet se në procedurat e shpallura të komandimit në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë nuk ka shprehur interes asnjë gjyqtar (me gjithë thirrjet e herë pas hershme të bëra nga KLGJ-ja).

Aktualisht, në pozicionin e inspektorit është i komanduar vetëm 1 (një) gjyqtar, për një afat të kufizuar kohor (deri në përfundim të procesit të ngritjes në detyrë ku

gjqitari ka kandiduar). Sa më lart, Inspektori i Lartë i Drejtësisë aktualisht paraqet nevojë edhe për 5 gjyqtarë të tjerë, për të shërbyer në pozicionin e inspektorit. Gjithashtu është në proces komandimi për një këshilltar magjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

b) Gjykata e Lartë:

Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, rezulton se sipas organikës së këtij institucioni, numri i këshilltarëve ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor është 34, nga ku mund të arrijmë në një konkluzion se numri i ndihmësmagjistratëve që duhet të shërbejnë në këtë njësi, është 18. Pra, referuar ligjit, sipas organikës aktuale, në Gjykatën e Lartë do të duhet të ketë në vijimësi 18 gjyqtarë të komanduar. Aktualisht në Gjykatën e Lartë janë të komanduar gjithsej 5 gjyqtarë, çka, do të thotë se Gjykata e Lartë paraqet nevojë edhe për 13 gjyqtarë të tjerë, për të shërbyer në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Njësinë e Shërbimit Ligjor.

c) Gjykata Kushtetuese:

Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese, rezulton se sipas organikës së këtij institucioni, numri i këshilltarëve ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor është 19, nga ku mund të arrijmë në një konkluzion se numri i ndihmësmagjistratëve që duhet të shërbejnë në këtë njësi, është 10 (pra jo më pak se gjysma). Sipas organikës aktuale rezulton se në Gjykatën Kushtetuese do të duhet të ketë në vijimësi 10 gjyqtarë të komanduar. Aktualisht në Gjykatën Kushtetuese nuk ka asnjë gjyqtar të komanduar, që do të thotë se Gjykata Kushtetuese paraqet nevojë për 10 gjyqtarë, për të shërbyer në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Njësinë e Shërbimit Ligjor.

ç) Këshilltarët e Komisioneve të Përhershme dhe Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional në KLGJ:

Aktualisht në njësinë mbështetëse të Komisioneve të Përhershme shërbejnë 2 gjyqtarë të komanduar dhe mbetet nevoja edhe për 1 gjyqtar të ri. Aktualisht në institucionet e sistemit të drejtësisë (pra në KLGJ, Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, Gjykatën e Lartë, Shkollën e Magjistraturës), janë të komanduar gjithsej 21 gjyqtarë,

ndërkohë që vetëm KLGJ-ja, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, aktualisht paraqesin nevojë edhe për 30 gjyqtarë të komanduar.

d) Shkolla e Magjistraturës:

Shkolla e Magjistraturës ka paraqitur nevojën për të komanduar 1 gjyqtar, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, për të cilën Këshilli ka nisur procedurën e komandimit.

e) Ministria e Drejtësisë:

Pas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për komandimin e një gjyqtari pranë këtij institucioni, më 1 janar 2023 është komanduar gjithashtu 1 gjyqtar edhe pranë këtij institucioni, në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”.

Sa më sipër, vetëm Këshilli i Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, paraqesin në vijimësi nevojë për 30 gjyqtarë të zgjedhur apo të komanduar.

Brenda numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor, në vijimësi, sipas përcaktimeve ligjore dhe organikave aktuale të institucioneve të sistemit të drejtësisë, jo më pak se 50 gjyqtarë do të duhet të shërbejnë në mënyrë të përhershme në vijimësi në këto institucione, çka do të thotë që ky numër, duhet të llogaritet brenda numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve mbajtur në konsideratë organikën aktuale (pra brenda numrit 408). 50 të tillë duhet të shërbejnë në institucione të tjera që nuk përfshihen në pushtetin gjyqësor.

Plotësimi i nevojave në sistemin gjyqësor:

Numri i kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës deri në vitin 2025, është si më poshtë:

Për vitin 2023, priten të diplomohen 40 kandidatë, të profilit gjyqtar.

Për vitin 2024, priten të diplomohen 32.

Për vitin 2025, priten të diplomohen 45.

Në total, deri në vitin 2025, priten të diplomohen 117 kandidatë për magjistratë, profili gjyqtar.

Sa më sipër, referuar nevojave aktuale në sistemin gjyqësor sipas pikës (1), pra referuar vendeve aktuale që i referohen vakancave të përhershme si pozicione të lira, që janë 91 vende, ato do të mund të plotësohen vetëm në vitin 2025.

Ndërkohë deri në vitin 2025 mbi supozimet e parashtruara më lart, është e pritshme që në sistemin gjyqësor të krijohen deri 66 vende vakante/pozicione të lira të përhershme. Një pjesë e tyre mund të plotësohen me një pjesë të magistratëve të diplomuar në vitin 2025 (pra 91 referuar edhe 117 që përmenda më lart për tre vite 2023 – 2024 – 2025). Nisur nga kjo, është e qartë se vakancat e përhershme që pritet të krijohen në sistemin gjyqësor deri në vitin 2025 nuk mund të plotësohen nga magistratët e diplomuar deri në këtë vit. Këto vakanca, mbeten për t'u plotësuar me të diplomuarit e vitit 2026, të cilët do të duhet të fillojnë procesin e formimit fillestar në vitin akademik 2023 – 2024.

Ndaj sa më sipër, ndërsa mund të supozohet që, në vitin 2026, në sistemin gjyqësor do të ketë jo më pak se 66 vende vakante/pozicione të lira të përhershme, për plotësimin e këtyre vakancave do të duheshin jo më pak se 40 magistratë të diplomuar në këtë vit, çka do të thotë se numri i kandidatëve magistratë, profili gjyqtar, që duhet të rekrutohen në vitin e ri akademik 2023 – 2024, do të duhet të jetë jo më pak se 40.

Por do të duhet të rikonsiderohet fakti se në qershor 2026 përfshihen në sistem edhe 7 anëtarët e KPA-së, gjithashtu në mbajmë në konsideratë edhe qëndrimin e GJEDNJ-së në vendimet e fundit për rihapje të proceseve, në këto rrethana propozohet që numri i magistratëve që duhet të rekrutohen në vitin e ri akademik 2023 – 2024 të jetë 40.

Të tjerë tregues për t'u mbajtur në konsideratë janë: eficienta e KPA-së, si edhe kohëzgjatja e procedurës së promovimit/ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, e cila diktohet ndër të tjera edhe nga procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve.

Mbi kapacitetet e Shkollës së Magistraturës:

Shkolla e Magistraturës ka 57 kandidatë të profilit gjyqtar dhe prokuror që ndjekin vitin e parë; 55 kandidatë të profilit gjyqtar dhe prokuror që ndjekin vitin e dytë dhe 66 kandidatë të profilit gjyqtar dhe prokuror në vitin e tretë.

Mbi koordinimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

Nga ana e përfaqësuesve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë u konsiderua e domosdoshme që, brenda kapaciteteve rekrutuese të Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023–2024, numri maksimal i kandidatëve magjistratë, profili prokuror, të ishte jo më pak 40.

Përfundime:

Sa më lart, duke marrë në konsideratë të kapaciteteve rekrutuese të Shkollës së Magjistraturës, por edhe koordinimit me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, numri maksimal i kandidatëve magjistratë, profili gjyqtar, si dhe i kandidatëve ndihmës ligjorë, që duhet të rekrutohen për vitin akademik 2023–2024, mund të përcaktohet në total 55. (40 kandidatë profili gjyqtar dhe 15 kandidatë profili ndihmës ligjor).

Në rrjedhje të kësaj, duke qenë parësore plotësimi i vakancave në pozicionin e gjyqtarit, përveç se dukshëm më të lartë nevojat e pritshme në një të ardhme të afërt, brenda numrit maksimal 55, do të duhet të konsiderohet një numër më i lartë për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, që duhet të rekrutohen në vitin e ri akademik 2023-2024, ku si i tillë është menduar numri 40, por që është numër variabël që edhe mund të ndryshojë.

Për numrin maksimal të kandidatëve këshilltarë ligjorë:

Gjykata e Lartë ka në organikën e saj 19 gjyqtarë. Aktualisht të emëruar në këtë funksion janë 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë, ndërkohë që mandati i njërit prej tyre, z. Kurushi, është i pezulluar, ndërsa ai aktualisht ushtron funksionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pra, aktualisht në detyrë janë 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë. Nga ana tjetër, Këshilli i Lartë Gjyqësor është duke zhvilluar procedurat e ngritjes në detyrë për 4 pozicione të lira në Gjykatën e Lartë dhe është e pritshme që këto pozicione të plotësohen brenda disa muajve.

Si dhe më lart u përmend, referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë, rezulton se sipas organikës së këtij institucioni, numri i këshilltarëve ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor është 34 (tridhjetë e katër), nga ku mund të arrijmë në një përfundim se numri i këshilltarëve ligjorë jomagjistratë, që duhet të shërbejnë në këtë njësi, është 16.

Aktualisht, në Njësinë e Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë ushtrojnë detyrën 19 këshilltarë ligjorë jomagjistratë, nga të cilët 7 prej tyre janë në proces rivlerësimi kalimtar sipas nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërkohë, rezulton se vijon procesi i verifikimit për një kandidat për këshilltar ligjor të diplomuar në vitin 2021. Për rrjedhojë, në vitin akademik 2023 – 2024 nuk paraqitet nevojë për kuota për këshilltarët ligjorë.

Sa më lart, nevoja aktuale për këshilltarë ligjorë jogjyqtar në Njësinë e Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë, është plotësuar me të diplomuarit e viteve të mëparshme.

Përfundime:

Sa më lart, në vitin akademik 2023 – 2024, nuk parashikohen kuota për kandidatët për këshilltarë ligjorë. Edhe në supozimin për ndonjë efekt të mundshëm negativ nga procesi i rivlerësimit kalimtar dhe ai i verifikimit të pasurisë dhe figurës për këshilltarët në detyrë, sërish numri i këshilltarëve ligjorë është tejkaluar.

Për numrin maksimal të kandidatëve ndihmës ligjorë:

Në zbatim të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 495, datë 21.10.2020, “Për krijimin e njësive të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”, vendosi krijimin e “Njësisë së Shërbimit Ligjor” si pjesë e strukturës së gjykatave të apelit, në total 51 pozicione.

Aktualisht, në njësitë e shërbimit ligjor të gjykatave të apelit janë të emëruar definitivisht ose përkohësisht 29 ndihmës ligjorë nga të cilët 17 prej tyre janë në proces rivlerësimi kalimtar, sipas nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në këto njësi shërbimi janë 22 pozicione vakante.

Gjatë viteve të mëparshme, formimin fillestar janë diplomuar si ndihmës ligjorë:

- i) Në vitin 2020 janë diplomuar 8 ndihmës ligjorë;
- ii) Në vitin 2021 janë diplomuar 3 ndihmës ligjorë;
- iii) Në vitin 2022 janë diplomuar 1 ndihmës ligjorë;
- iv) Në vitin 2023 pritet të diplomohen 3 ndihmës ligjorë.

Pra, aktualisht, njësitë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit paraqesin nevojë për 18 ndihmës ligjorë (mbajtur në konsideratë se 3 ndihmës ligjorë diplomohen në vitin 2023 dhe 1 ndihmës ligjor i diplomuar në vitin 2022 është në proces verifikimi).

Sa i përket parashikimit ligjor, për numrin e ndihmësve ligjorë pranë gjykatave të shkallëve të para, vlerësohet se kjo nevojë do të analizohet, pasi të miratohet harta e re gjyqësore, pra pasi të implementohet harta e re gjyqësore për gjykatat e shkallëve të para.

Përfundime:

Duke mbajtur në konsideratë nevojat aktuale dhe ato të pritshme në një të ardhme të afërt, lidhur me numrin e kandidatëve për ndihmës ligjorë, që duhet të rekrutohen në vitin e ri akademik 2023 – 2024, ky numër, sipas projektvendimit të propozuar, është menduar të përcaktohet në 15, duke mbajtur në vëmendje kërkesat e viteve të kaluara për këtë pozicion.

Struktura e projektvendimit

Mbi Projektvendimin “Për numrin e kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar dhe të kandidatëve ndihmës ligjorë, që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024”.

Projektvendimi, pika 1/a, parashikon që numri i kandidatëve për magjistratë/profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 - 2024, të jetë 40 (dyzet), ndërkohë që pika 1/b parashikon se numri i kandidatëve ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024, të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) kandidatët ndihmës ligjorë.

Sipas projektvendimit, pika 1/c, parashikohet se në rast se nga konkurrentët nuk arrihen pikët që nevojiten për kandidatët magjistratë, kuotat e mbetura mund t’i shtohen numrit të përgjithshëm të kandidatëve ndihmës ligjorë, të cilët plotësojnë nivelin minimum të pikëve që parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Në projektvendim, pika 2, parashikohet se Shkolla e Magjistraturës publikon thirrjen për kandidime për formimin fillestar, brenda një jave kalendarike nga data e publikimit të numrit maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, sipas pikës 1, shkronja “a”, të këtij vendimi, nëpërmjet shpalljes së njoftimit: i) në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës; ii) në të paktën një prej gazetave me tirazh më të lartë në vend.

Pika 3 e projektvendimit, përcakton se procesi i regjistrimit për konkurrim të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, bëhet në Shkollën e Magjistraturës dhe vlerësimi paraprak për plotësimin e kriterëve kryhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Pika 4 e projektvendimit, përcakton se Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatët e interesuar për ndihmës ligjorë, për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve të publikuara: i) pranë të gjithë gjykatave; ii) në faqet zyrtare të gjykatave, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Ndërkohë, sipas pikës 5 të projektvendimit, përcaktohet se afati për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nga kandidatët e interesuar për magjistratë/profili gjyqtar, si dhe për ndihmës ligjorë, është deri më datë 28 shkurt 2023.

Projektvendimi, në pikën 6, ka të parashikuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojë kandidati ndihmës ligjor, për t’u pranuar në provimin e pranimit në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, referuar për këtë edhe në nenet 34/6, 55/1, 56, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (me ndryshime) si dhe në nenin 21, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në projektvendim, në pikën 7, është përcaktuar edhe dokumentacioni që duhet të paraqesë kandidati ndihmës ligjor në momentin e aplikimit.

Po ashtu, projektvendimi, në pikën 8, përcakton se procesi i regjistrimit për konkurrim i kandidatëve ndihmës ligjorë kryhet në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, dhe se kandidatët që plotësojnë kriteret, i nënshtrohen konkursit të pranimit, duke paguar tarifën e regjistrimit për pjesëmarrjen në konkurs sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës (pika 9).

Së fundi, në Projektvendim përcaktohet edhe momenti i hyrjes në fuqi të vendimit dhe botimit të tij në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi për relacionin lidhur me propozimin e projekt-aktit.

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë sugjerim.

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, jo pa debat ka kaluar edhe përcaktimi i këtij numri kandidatësh për vitin që referohet. Ndërkohë që, në opinionin tim është një numër {...} i lartë, porë edhe nga këndvështrimi i ecurisë së disa aktorëve të cilët ndërthuren edhe me punën tonë.

Pra që një vend i përkohshëm të kthehet përfundimisht në të përhershëm do të duhet që organet e vetting–ut mund të shprehen me një vendim të veçantë, qoftë KPK–ja apo KPA–ja. Por dukshëm, duket që gjatë gjithë trendit që ata kanë, rezulton që nuk kanë të njëjtën frekuencë nxitimi siç KLGJ–ja ka për të plotësuar objektivat e saj, plotësimin e atyre vakancave të cilat janë krijuar vit pas viti dhe që ka krijuar edhe {...} probleme në lidhje me aplikimin e drejtësisë.

Në trendin më të mirë, po i referohem KPA–së, 2020–2021, KPA–ja ka dhënë diku tek 30 e ca vendime të formës së prerë. Kjo do të thotë, ky vendim, në atë moment, konverton një pozicion të lirë të përkohshëm, në një pozicion të lirë të përhershëm. Që do të thotë, në këtë moment është i gatshëm që ky vend t’u vihet në dispozicion kandidatëve të cilët kanë kandiduar dhe presin emërimin.

Por ndërkohë, ekzistojnë edhe skema të tjera të cilat krijojnë pozicione të lira të përhershme, siç janë instituti i lëvizjes paralele dhe ai i ngritjes në detyrë, të cilët edhe këto dukshëm janë ndikuar po nga vendimmarrjet e organeve vetting, për shkak sepse bazën e kanë vlerësimin. Në kushtet kur shumë gjyqtarë nuk e kanë kaluar vetting-un, atyre nuk mund t’u bëhet dot as gradimi, që është pjesë e vlerësimit të tyre. Por vetë vlerësimi ka në vetvete dhe përfshin procedura të cilat kërkojnë kohë, trendi ka treguar

që zgjasin, kjo jo vetëm për efekt..., sepse edhe këtu jemi të detyruar të veprojmë me aktorë të tjerë të cilët plotësojnë aktet në kuadër të vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve, por edhe nga burimet e cingura njerëzore që ne disponojmë.

Mos harrojmë se teorikisht duhet të kishim 7 gjyqtarë, dhe nëse mbështetemi tek opinionin 17/2014 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë i cili thotë që për të mbrojtur pavarësinë e gjyqësorit, vlerësimi duhet të merret kryesisht nga gjyqtarët, në gjendjen aktuale ku kemi vetëm 4 (2 janë në dispozicion të organeve të vetting–ut dhe 2 në dispozicion të vlerësimit të gjyqtarëve), gjendja bëhet më dramatike kur mendon që duhet të evadosh dhe të krijosh shumë vendime vlerësimi, në mënyrë që gjyqtarët të lëvizin në mënyrë paralele dhe nga ana tjetër, të ngrihen në detyrë, duke krijuar kështu pastaj pozicione të lira të përhershme të cilat do të jenë të gatshme për të pritur rekrutët e rinj të cilët vit pas viti prodhon Shkolla e Magjistraturës për gjyqtarë.

Por jo pa efekt është edhe vetë kapaciteti, që nuk e kam parë nëse, Shkolla e Magjistraturës është e aftë të prodhojë gjithë këtë bum magistratësh, kur dihet që prokuroria vetë ka një numër 40, ne 40, futi edhe 10 ndihmësmagjistratë dhe shkon diku tek 90 numri. A është e aftë kjo shkollë, që duke ruajtur cilësinë, mos rendë pas sasisë, të kërkojë dhe të bëjë një punë efektive në krijimin e brezit të ri të magistratëve, që nesër–pasnesër mos na duhet të bëjmë një reformë bis, pikërisht për efekt të rendies pas sasisë dhe shkeljes së cilësisë.

Kështu që në këtë kuadër, unë do të propozoja numrin 30, të cilës i referoj trendit aktual ose më të mirë të KPA–së, e cila konverton pozicionet e lira të përkohshme, në pozicione të lira të përhershme. Ky është propozimi im, 30.

Naureda Llagami: Tjetër diskutim?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Paraprakisht doja të falënderoja zotin Kurushi për një pasqyrim shumë analitik të të gjithë treguesve mbi të cilat prej Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është konkluduar në përcaktimin e numrit 40.

Para se unë të jap mendimin tim lidhur me kuotat e propozuara, paraprakisht dua të shpreh disa konsiderata, duke qenë se ky është një nga projektvendimet e para të fillimit të çdo viti që Këshilli merr mbi përcaktimin e numrit të kuotave për studentët ose për kandidatët për gjyqtarë që duhet t'i nënshtrohen programit të trajnimit fillestar.

Sigurisht që ky studim që paraqitet në mbledhjen plenare, në fakt është evidentim i gjendjes aktuale të sistemit, pra është më gjerë sesa një vendim propozues për kuotën, por nga ana tjetër është edhe një studim mbi mundësinë e parashikimit të pritshmërive dhe rezultateve të këtyre pritshmërive që do të ndodhin pas tre viteve.

Çka ndodhur vitet e mëparshme ku ne kemi përcaktuar kuotën?

Nuk kemi qenë të kushtëzuar kaq shumë sa sot nga ecuria e procesit të vlerësimit kalimtar, sepse vitet e mëparshme kemi pasur shumë herë më pak vendime të formës së prerë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe trendi apo projeksioni që Këshilli ka marrë parasysh mund të ketë qenë 40%, 50%, ndoshta edhe më shumë. Në këtë kuadër na ka ndikuar simulimi “Monte Carlo” i bërë nga një ekspert ndërkombëtar, i asistuar nga projektet që mbështesin Këshillin, është z. {...}, ekspert i cili ka mbështetur me projeksionet e veta edhe studimet mbi hartën e re gjyqësore, i cili çdo vit, duke marrë të gjitha të dhënat që zoti Kurushi i përmendi në relacionin e vet, sipas një procesi “Monte Carlo” me simulime, na ka paraqitur edhe disa grafikë mbi modelin dhe vijueshmërinë që do të kishte numri i kuotave që Këshilli duhet të miratojë, gjithmonë duke pasur parasysh që plotësimi i vakancave me 408 gjyqtarë, të ndodhë sa më shpejt.

Nga projeksioni që zoti {...} na ka paraqitur sivjet, rezulton që sigurisht ne nuk mund të biem poshtë numrit 40 dhe kjo është jo vetëm për sa i përket analizës matematikore të të gjithë të dhënave që ai ka futur në projeksion, por edhe sipas një analize logjike. Kjo analizë logjike është bërë më gjerë nga eksperti. Janë marrë parasysh jo vetëm trendët dhe ecuria e procesit të rivlerësimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por janë futur edhe projeksione si do shkonte ky proces për gjyqtarët që nuk i janë ushtruar nënshtroar akoma Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në vlerësimin tim, këta të dytët duhet të kihet parasysh (janë rreth 63 gjyqtarë nëse nuk gaboj) në kuotat e vitit tjetër, duke qenë se do tre vjet që këto vakanca, nëse do të kthehen sipas projeksionit, në vakanca të përhershme apo të përkohshme për sa i përket shkarkimit,

do të jenë kuota të lira për t'u marrë në konsideratë në përcaktimin e numrit të kuotave në vitet pasardhës.

Nga ana tjetër, vlerësoj që ky vendimi i sotshëm për kuotën, pavarësisht se është reflektim mbi nevojën për të plotësuar sistemin, do të ndikojë shumë edhe në uljen e backlog-ut. Pavarësisht se ne kemi miratuar hartën e re gjyqësore, si je nga mekanizmat që çon në uljen e backlog-ut, gjithmonë, nevoja për gjyqtarë të rinj është e evidente sepse po e shohim që backlog-u nga Gjykata e Lartë tashmë ka zbritur në gjykatën e apelit dhe po kështu kemi edhe një backlog të akumuluar në gjykatat e shkallës së parë. Që të plotësojmë nevojat e apelit me gjyqtarë, duhet patjetër që këta gjyqtarë t'i marrim nga gjykata e shkallës së parë dhe për këtë arsye është e nevojshme që të kemi sa më shumë gjyqtarë në gjykatat e shkallës së parë, për të plotësuar vendet vakante që ne kemi.

Nga ana tjetër, ky studim mbi kuotat është edhe përgjegjësi për Këshillin. Përgjegjësi në kuptimin që këto vende vakante ne duhet t'i plotësojmë sa më shpejt. Unë jam dakord me fjalën e Albanit që sigurisht ne kemi pasur shumë vështirësi për sa i përket procedurave të ngritjes në detyrë dhe të vlerësimeve, disa vështirësi që nuk varen vetëm prej nesh, siç mund të jenë burimet njerëzore apo ecuria e proceseve të vlerësimit për shkak sepse ne mbledhim shumë burime vlerësimi, por në qoftë se ne do të fillojmë sot dhe në vijim të këtij viti, me të hapur të gjitha vakancat, duke marrë parasysh të gjithë kohëzgjatjen që na duhet, do të kemi pritshmëritë që të paktën për një vit të kemi mundësi që të fillojmë dhe të plotësojmë. Procesi i vlerësimit ka treguar që, duke qenë që je i ndikuar nga një proces gradimi, duhet patjetër që të vijë dosja nga organet e rivlerësimit që të fillosh gradimin, të fillosh të marrësh burime të tjera të vlerësimit (dhe të mos hyjmë në gjëra teknike), por duhet të fillojmë sot për të menduar që në 2026 të paktën të bëjmë realitet këtë qëllim që ne marrim parasysh sot me 40 kuota.

Unë e vlerësoj të gjithë punën e bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Edhe nga ana ime kam qenë e dyzuar lidhur me numrin. Pasi kam marrë edhe mendimin e ekspertit, kam bërë edhe vetë një projeksion i cili më shkon po pikërisht në 40 kuota.

Duke marrë parasysh gjendjen aktuale të sistemit gjyqësor, pra ne sot kemi 91 pozicione të lira që kërkojnë magjistratë në sistem.

Kemi 20 gjyqtarë të cilët presin të dalin në pension në vitin 2026, duke përfshirë këtu edhe gjyqtarët për të cilët zgjatën moshën e pensionit nga 67 në 70 vjeç.

Kemi gjithashtu një situatë që lidhet me respektimin e së drejtës për t'u emëruar gjyqtar apeli për gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Theksoj që ata duhet të kthehen nëse mbarojnë mandatin në mesin e 2027–ës, por duhet të llogariten në kuotën e 2026–ës, sepse në 2027–ën, të tjerët që vijnë do të futen në korrik nga 2024.

Duhet të marrim parasysh numrin e magjistratëve të rinj që hyjnë në sistem në 2023, 2024, 2025 dhe sipas të dhënave që u prezantuan nga zoti Kurushi janë 117 magjistratë.

Gjithashtu duhet të marrim parasysh edhe nevojën që në vitin 2026, të paktën, të kemi mundësi që sistemi të plotësohet me numrin total prej 408 gjyqtarësh, me qëllim që të jetë efektiv dhe eficient dhe backlog-u i krijuar të ketë mundësi të reduktohet dhe situata t'i kthehet normalitetit.

Gjithashtu duhet të vlerësojmë edhe ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar dhe kjo ecuri deri në korrik të vitit 2026.

Në këtë kuadër, unë kam konstatuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit shqyrton vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mesatarisht pas kalimit të një afati 2–vjeçar. Çka do të thotë që në vitin 2026 duhet të kenë përfunduar ankimet e viteve 2021 dhe viteve 2022 si dhe 7 ankime të mbetura nga viti 2020.

Më konkretisht, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka në shqyrtim ende 7 ankime të vitit 2020 që janë vendime ndaj shkarkimit për 7 gjyqtarë; 38 ankime të vitit 2021 ndaj vendimeve të shkarkimit për 38 gjyqtarë; 17 ankime të vitit 2022 ndaj vendimeve të shkarkimit për 17 gjyqtarë dhe 7 vendime konfirmimi për 7 gjyqtarë. Pra në total, janë 62 vendime shkarkimi që kanë pritshmëri legjitime të kenë mbaruar në KPA në vitin 2026 dhe 6 vendime konfirmimi.

Nga ana tjetër, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka ende pa shqyrtuar deri në datën 31.12.2022, 128 ankime ose 128 çështje (këtu kam futur edhe gjyqtarë edhe prokurorë), për të cilat, nëse do të llogarisim një mesatare prej 40 vendimesh në vit, del një mesatare kohëzgjatjeje prej 3 vjetësh. Çka do të thotë që të gjitha çështjet kanë pritshmëri që nëse

vijohet me të njëjtat ritme pune, të kenë mbaruar në vitin 2026. Kemi tre vite pune: 2023, 2024, 2025.

Ndërkohë që trendi i vendimmarrjes së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, deri në vitin 2022 rezultoi i tillë: nga 103 shkarkime (gjyqtarë dhe prokurorë) të marra në shqyrtim, për të cilat vendimet janë publikuar, vetëm 8 prej tyre janë ndryshuar. Pra përqindja e vendimeve të shkarkimit të mbetur në fuqi deri tani në KPA (pra 8 me 103) është afërsisht 82%; aftësisht 8% e numrit total të vendimeve të shkarkimit të ankimuar janë ndryshuar në konfirmim, trend i cili ka ardhur në rritje në vitin 2022 në drejtim të konfirmimit në detyrë; ndërsa nga 55 vendime konfirmimi, rezultoi që të kenë ndryshuar 25 vendime, pra 55% e tyre, përqindje që ka ardhur duke u zvogëluar në vitin 2022 në drejtim të mbetjes në fuqi të konfirmimit në detyrë.

Gjithashtu duhet të marrim parasysh edhe numrin e dorëheqjeve. Në total, nga krijimi i KLGJ-së, deri tani, kanë hequr dorë nga statusi rreth 58 gjyqtarë nga 408 në total, ndërkohë që pritet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar 63 gjyqtarë, i cili është edhe numër që sipas të dhënave që kemi ka mbetur pa kaluar ende në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Pra duke konsideruar vetëm vakancat e përhershme aktuale në sistem dhe ato të sigurta për shkak të pensionit deri në korrik 2026, nevojat për burime njerëzore janë 91 plus 20, për 111 gjyqtarë. Nga kjo shumë, duhet të zbrisim 7 pozicione për shkak të hyrjes në sistem të anëtarëve të KPA-së, çka çon në nevojën për 104 gjyqtarë. Ndërkohë që deri në vitin 2025 do të hyjnë në sistem 117 gjyqtarë, çka do të thotë se pa llogaritur ecurinë e procedurës së rivlerësimit kalimtar, do të kemi një tejkalim të numrit të parashikuar me atë sipas nevojave, me 13 gjyqtarë. Pra nëse nuk do të marrim parasysh rivlerësimin në sot me nevojat që kemi, kemi 13 gjyqtarë plus me kuotat që kemi parashikuar.

Nga ana tjetër, duke marrë në konsideratë numrin 62 (deri në fund të vitit 2022) të ankimeve ndaj vendimit të shkarkimit që Kolegji i Posaçëm i Apelimit pritet të shqyrtojë deri në vitin 2026, si dhe duke zbatuar një përqindje prej 80% të shkarkimeve që mund të lihen në fuqi, duke ulur përqindjen në varësi të trendit për vitin 2022, do të na rezultojë që deri në vitin 2026, të përballemi me afërsisht 50 vakanca të reja (49.6%).

Edhe sikur të pranojmë që 7 ankimet e tjera ndaj vendimeve të konfirmimit do të mbeten në fuqi, nevojat për 50 pozicione të lira të përhershme duhet të konsiderohen në përcaktimin e numrit të magistratëve për vitin akademik 2023–2026. Nëse nga ky numër do të zbrisim numrin 13 që na rezulton tejkallim numri i gjyqtarëve si më lart, nevojat për të plotësuar tërësisht vakancat e përhershme që priten në sistem në korrik 2026, rezultojnë të jenë për 37 gjyqtarë. Nëse këtij numri do t'i shtonim sikur vetëm 3 gjyqtarë (por unë mendoj që mund të jenë edhe më shumë sipas projeksionit) që mund të largohen me dorëheqje apo për shkak të procedimeve disiplinore, të referuar nga zoti Kurushi, numri i nevojshëm dhe i arsyeshëm i kuotave për praninë në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2023-2026 shkon në 40 kuota për gjyqtarë dhe mendoj që është kufiri minimal që edhe eksperti na ka rezultuar, nga ku nuk mund të zbrisim poshtë tij.

Prandaj unë bashkohem me propozimin e bërë nga zoti Kurushi, që duke vlerësuar të gjithë indikatorët e mësipërm, bazuar në një analizë matematikore dhe logjike për të pasur një sistem tërësisht funksional, të plotësuar me 408 gjyqtarë në vitin 2026, parashikueshmëria sipas pritshmërive të mësipërme, passjell nevojën për të pasur 40 kuota profili gjyqtar, për vitin akademik 2023–2026, që do të futen në sistem në korrik të vitit 2026.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ndonjë koleg tjetër mbi propozimin?

Atëherë, duke qenë se s'kemi më propozime, sipas procedurës, hedhim në votim fillimisht propozimin e zotit Toro, i cili vjen në ndryshim nga propozimi i ardhur nga Komisioni, nga 40 në 30 kuota për kandidatë. Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Kundër propozimit.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër propozimit.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi i zotit Toro.)

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin e ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përcaktimin e numrit të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar dhe i kandidatëve ndihmës ligjorë, që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024, si më poshtë:

a. Numri i kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024, është 40 (dyzet).

b. Numri i kandidatëve ndihmës ligjorë, që pas kalimit të testimit profesional, do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024, është 15 (pesëmbëdhjetë), kandidatë ndihmës ligjorë.

c. Në rast se nga konkurrentët nuk arrihen pikët që nevojiten për kandidatët magjistratë, kuotat e mbetura mund t'i shtohen numrit të përgjithshëm të kandidatëve ndihmës ligjorë, të cilët plotësojnë nivelin minimum të pikëve që parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

2. Shkolla e Magjistraturës publikon thirrjen për kandidime për formimin fillestar, brenda një jave kalendarike nga data e publikimit të numrit maksimal të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, sipas pikës 1, shkronja “a”, të këtij vendimi, nëpërmjet shpalljes së njoftimit:

- i) në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës;
- ii) në të paktën një prej gazetave me tirazh më të lartë në vend.

3. Procesi i regjistrimit për konkurrim të kandidatëve magjistratë/profili gjyqtar, bëhet në Shkollën e Magjistraturës dhe vlerësimi paraprak për plotësimin e kriterëve kryhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

4. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatët e interesuar për ndihmës ligjorë për paraqitjen e kërkesave për formim fillestar, nëpërmjet njoftimeve të publikuara:

- i) pranë gjithë gjykatave;
- ii) në faqet zyrtare të gjykatave, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Shkollës së Magjistraturës.

5. Afati për paraqitjen e kërkesave për formimin fillestar, nga kandidatët e interesuar për magjistratë/profili gjyqtar, si dhe për ndihmës ligjorë, është deri më datë 28 shkurt 2022.

6. Për t'u pranuar në provimin e pranimit për formimin fillestar për ndihmës ligjor, kandidati duhet të plotësojë njëkohësisht kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

dh) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

e) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

ë) të mos ketë qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete;

f) të mos jetë anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;

g) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë [...];

gj) të ketë notë mesatare të përgjithshme mbi 7 (shtatë), si dhe notë mesatare mbi 7 (shtatë) për grupin e lëndëve kryesore, ku përfshihen: E drejta civile dhe e detyrimeve, E drejta penale, Procedura civile, Procedura penale, E drejta administrative dhe E drejta kushtetuese. Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj, parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të ponderojë mesataren e tyre faktike.

Kriteret e veçanta për ndihmës ligjorë:

a) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare.

7. Në dosjen personale për regjistrim, kandidati për ndihmës ligjor duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme, ose kopje të tyre të noterizuara:

a) kërkesën personale [...];

b) jetëshkrimin;

c) deklaratën ku të garantojë vërtetësinë e dokumentacionit që paraqet;

ç) diplomat universitare dhe pasuniversitare për studimet që ka ndjekur, si dhe vërtetimin e notave;

d) vetëdeklarimin për gjendjen gjyqësore;

dh) raportin mjekoligjor për aftësimin e tij të përgjithshëm dhe të specializuar në kuadër të kryerjes së detyrës si këshilltar apo ndihmës ligjor [...];

e) dëshmi, vërtetime nga punëdhënësi/t [...];

ë) dëshmi, vërtetime nga punëdhënësi/t [...];

f) deklaratë që nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;

g) deklaratë që nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit [...];

gj) deklaratë që nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

8. Procesi i regjistrimit për konkurrim i kandidatëve ndihmës ligjorë kryhet në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.

9. Kandidatët ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret, i nënshtrohen konkursit të pranimit, duke paguar tarifën e regjistrimit për pjesëmarrjen në konkurs sipas rregullave të Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 31.01.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022 – 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 13:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Marçela Shehu**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

5. Të tjerë: Petrika Thanu, gazetar (MCN-Press).

Largohen nga salla gjatë trajtimit të çështjes:

1. John Kastning, Drejtor i Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjzbatimit (EWMI-INL).

2. Sarmela Titka, përfaqësuese (EWMI-INL).

3. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

4. Tidita Fshazi, përfaqësuese e delegacionit të Bashkimit Evropian.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022 – 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, kërkoj administratën për çështjen “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik

2022 – 2023”, që ka të bëjë me hedhjen e shortit për kandidatët që do të verifikohen nga Këshilli. Kështu që fillojmë.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish zotit Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Pa humbur kohë po parashtrojmë përpara Këshillit projektvendimin, bashkëlidhur edhe relacionin përkatës “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022 – 2023”.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 136/a, pika 1), si dhe Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 35, pika 1, shkronja “c”), emërimi gjyqtar, i shtetasit shqiptar që është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme, si dhe është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, është një proces i cili paraprihet dhe kushtëzohet nga kalimi me sukses i procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, proces për të cilin ligji ngarkon Këshillin e Lartë Gjyqësor ta kryejë atë, ndërsa vet si proces ky rregullohet referuar ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (pikërisht i referohem nenit 32, pikat 2 deri në 6), sikundër edhe aktit nënligjor të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Referuar kuadrit ligjor në fuqi, procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës për gjyqtarët që pritet të diplomohen në përfundim të formimit fillestar, fillon brenda një jave nga dërgimi pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, prej Shkollës së Magjistraturës, të listës së kandidatëve magistratë, që pritet të diplomohen gjatë vitit respektiv akademik, listë e cila, sipas nenit 34, pika 1, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të dërgohet jo më vonë se në fund të muajit janar, të çdo viti prej Shkollës së Magjistraturës.

Nga ana tjetër, referuar nenit 35, pika 4, rezulton një detyrim edhe për Këshillin e Lartë Gjyqësor, për emërimin apo refuzimin e emërimit të të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës, brenda një muaji nga data e publikimit të listës së të diplomuarve (është një detyrim ligjor i cili i ngarkohet në këtë rast KLGJ-së për t'u respektuar dhe zbatuar prej tij).

Sipas nenit 39 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet ndër të tjera se: “Brenda muajit qershor të çdo viti, pas përfundimit të procedurave të transferimit paralel dhe ngritjes në detyrë, secili Këshill shpall vendet e lira për të emëruarit. Jo më vonë se dy javë nga shpallja e vendeve të lira, të emëruarit i bëjnë me dije Këshillit, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata ose prokurori në të cilat kërkojnë të caktohen. 2. Brenda muajit korrik të çdo viti, secili Këshill publikon vendimet e tij për caktimin e të emëruarve në pozicionet e lira për magjistrat.”

Për realizimin e procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të ndjek një sërë procedurash dhe ajo që është më e rëndësishme, do të duhet të administrojë informacione/raporte nga të gjithë subjektet që po ligji përcakton si të tilla për të bërë informacione, për t'i dhënë pra Këshillit informacione. Përmbyllja në kohë e procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët për gjyqtarë, kushtëzohet nga raportimet në kohë të subjekteve që ligji cakton si të tillë.

Pasur parasysh faktin që zhvillimi i këtij procesi si më sipër, ishte i pamundur të mbyllej brenda afatit të caktuar, ligjvënësi bëri të mundur ndryshimin e nenit 34 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke i dhënë të drejtë Këshillave të fillojnë verifikimin e pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimit: “Çdo vit, jo më vonë se në fund të muajit janar, Shkolla e Magjistraturës u dërgon Këshillave listën e kandidatëve që mund të diplomohen në përfundim të vitit akademik për verifikimin e pasurisë dhe figurës, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 32 të këtij ligji.”

Në këto kushte, për të bërë të mundur përmbushjen në kohë të detyrimit për emërim dhe caktim në pozicion të të sapodiplomuarve në Shkollën e Magjistraturës, sipas përcaktimi ligjor cituar më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të fillojë më herët

procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës për ata, me qëllim për ta përmbyllur procesin e emërimit dhe caktimit në pozicion të magistratëve brenda muajit korrik.

Sa më lart, Shkolla e Magjistraturës, me anë të shkresës nr. 48 prot., datë 13.01.2023, protokolluar në Këshill me nr. 181 prot., datë 017.01.2023, ka dërguar dhe një listë me emrat e 40 (dyzet) kandidatëve për magistratë, që janë në pritje për t'u diplomuar, në vitin akademik 2022 – 2023, në përfundim të vitit të tretë të Programit Trevjeçar të Formimit Fillestar.

I. Vlerësimi i Komisionit

Për sa më lart, mbështetur në pikën 1, të nenit 136/a dhe në shkronjat “a” e “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 32, nenin 34 dhe nenin 35, të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 61 dhe në shkronjën “ë”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikat 1 dhe 2, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë,...”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022 – 2023”.

Nëse ndonjë nga kandidatët për magistrat që janë në vitin e fundit të programit të formimit fillestar (trevjeçar) nuk do të diplomohet ose do të diplomohet, por jo me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme apo me vlerësim më të ulët se "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit/praktikës profesionale të vitit të fundit të formimit fillestar, ekziston mundësia që procesi i verifikimit i ndjekur për ata nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të mos këtë asnjë vlerë. Gjithsesi, një supozim i tillë, pavarësisht faktit se referuar statistikave shumëvjeçare të Shkollës së Magjistraturës ka pak gjasa të ndodh, në vlerësim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës nuk mund të përbëjë arsye, për të mos filluar sa më parë procesin e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar, proces ky që në çdo rast do të përmbillet vetëm pas diplomimit të tyre dhe marrjes nga Këshilli të listave përkatëse të diplomimit nga Shkolla e Magjistraturës.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga dy pika. Në pikën e parë të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022 – 2023.

Në pikën 2 të projektvendimit bëhet fjalë për caktimin e relatorit për secilin kandidat, çka realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, sikurse përcaktohet në pikën 2, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, ...”.

Propozohet që për shkak të ngarkesës dhe angazhimeve të Kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ai të ketë 10 (dhjetë) kandidatë, ndërsa 2 anëtarët e tjerë të Komisionit nga 15 (pesëmbëdhjetë) kandidatë.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe e shoqëruar me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, jemi dakord me propozimin që erdhi për shpërndarjen e ngarkesës?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Klodian Kurushi (që sipas propozimit në relacion, do të jetë relator për 10 nga kandidatët); z. Dritan Hallunaj (që sipas propozimit në relacion, do të jetë relator për 15 nga kandidatët) dhe z. Alban Toro (që sipas propozimit në relacion, do të jetë relator për 15 nga kandidatët).

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e kandidatëve për magjistratë: 1.z. {...}; 2.znj. {...}; 3. znj. {...}; 4.z. {...}; 5.znj. {...}; 6.z. {...}; 7.z. {...}; 8.z. {...}; 9.z. {...}; 10. znj. {...}; 11.z. {...}; 12. znj. {...}; 13.z. {...}; 14. znj. {...}; 15. znj. {...}; 16. znj. {...}; 17. znj. {...}; 18. znj. {...}; 19. znj. {...}; 20.z. {...}; 21. znj. {...}; 22. znj. {...}; 23. znj. {...}; 24. znj. {...}; 25.znj. {...}; 26. z. {...}; 27. z. {...}; 28. z. {...}; 29.znj. {...}; 30.znj. {...}; 31. z. {...}; 32.znj. {...}; 33.znj. {...}; 34. z. {...}; 35. z. {...}; 36. z. {...}; 37. z. {...}; 38. z. {...}; 39.znj. {...}; 40.znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të parë, i cili është z. Alban Toro. Zoti Toro do të jetë relator për 15 kandidatë për magjistratë të përzgjedhur sipas radhës më poshtë vijon: 34. z. {...}; 37. z. {...}; 14. znj. {...}; 39.znj. {...}; 30.znj. {...}; 18. znj. {...}; 8.z. {...}; 33.znj. {...}; 3. znj. {...}; 17. znj. {...}; 36. z. {...}; 13.z. {...}; 4.z. {...}; 38. z. {...}; 12. znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të dytë, i cili është z. Dritan Hallunaj. Zoti Hallunaj do të jetë relator për 15 kandidatë për magjistratë të përzgjedhur sipas radhës më poshtë vijon: 6.z. {...}; 16. znj. {...}; 11.z. {...}; 24. znj. {...}; 7.z. {...}; 27. z. {...}; 2.znj. {...}; 1.z. {...}; 29.znj. {...}; 23. znj. {...}; 32.znj. {...}; 20.z. {...}; 15. znj. {...}; 31. z. {...}; 40.znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të tretë (emri i mbetur në enën e qelqit), i cili është z. Klodian Kurushi. Zoti Kurushi do të jetë relator për 10 kandidatë për magjistratë të përzgjedhur sipas radhës më poshtë vijon: 35. z. {...}; 26. z. {...}; 19. znj. {...}; 21. znj. {...}; 5.znj. {...}; 28. z. {...}; 25.znj. {...}; 22. znj. {...}; 10. znj. {...}; 9.z. {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, hedhim në votim shortin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022 – 2023.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

- 1.Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
- 2.Për kandidatin znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
- 3.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro.
- 4.Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro.
- 5.Për kandidatin znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi.
- 6.Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
- 7.Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
- 8.Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro.
- 9.Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi.
- 10.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi.
- 11.Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
- 12.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro.
- 13.Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro.
- 14.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro.

- 15.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
- 16.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
- 17.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro.
- 18.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro.
- 19.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi.
- 20.Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
- 21.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi.
- 22.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi.
- 23.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
- 24.Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
25. Për kandidaten znj. {...} –relator z. Klodian Kurushi.
26. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi.
27. Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
28. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi.
29. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
30. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro.
31. Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
32. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.
33. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro.
34. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro.
35. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi.
36. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro.
37. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro.
38. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro.
39. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro.
40. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 31.01.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

3.1 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale;

3.2 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale;

3.3 Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 13:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Marçela Shehu.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 5. Valbona Bala, eksperte (INL)**
- 6. Të tjerë: Petrika Thano, gazetar (MCN-Press).**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

3.1 Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale;

3.2 Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale;

3.3 Për transferimin e gjyqtarës {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës me relator z. Alban Toro, për transferimin e gjyqtareve {...}, {...} dhe znj. {...}.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, në retrospektivë, siç edhe jemi në dijeni, në kuadër të përmirësimit të funksionalitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ana e Këshillit janë marrë disa masa, ndër të tjera dhe fillimi i procedurës së lëvizjes paralele për disa pozicione.

Në zbatim të parimeve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 42 të ligjit “Për statusin”, fillimisht dhe pasi konstatoi që në disa gjykata, si në Kurbin, Dibër dhe në Lushnjë kishte gjyqtarë që ishin jashtë strukturës, me vendimet 8, 9 dhe 10 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosi t’u njohë të drejtën këtyre gjyqtareve të cilat ishin jashtë strukturës, për të zgjedhur për t’u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, konkretisht: Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës penale; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës penale.

Natyrisht u administruan vullnetet përkatëse të gjyqtareve, të cilat kanë përzgjedhur si gjykatë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe fushën e së drejtës, atë penale.

Pas administrimit të vullnetit të ardhur nëpërmjet përgjigjeve nëpërmjet shkresave të administruara në dosjen përkatëse, nga ana e Komisionit ju është përgatitur ky draft, me tre drafte të veçanta (individuale), ku kanë të përbashkët në dispozitiv: transferimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatat e rrethit gjyqësor Dibër, Kurbin dhe Lushnjë, ku ishin caktuar në mënyrë të përhershme.

Një kopje e vendimit i njoftohet atyre sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Kurbin dhe Lushnjë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim, hedhim në votim projekt-aktet.

Projekt-akti i parë është “Për transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, projekt-akti u miratua sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë. Hedhim në votim transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt–akti sipas propozimit të Komisionit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt–akti i fundit që ka të bëjë me transferimin e gjyqtares {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt–akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 31.01.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, të gjyqtares {...}, relatores znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 13:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 5. Valbona Bala, eksperte (INL)**
- 6. Të tjerë: Petrika Thano, gazetar (MCN-Press).**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, të gjyqtarës {...}, relatores znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e fundit për mbledhjen e sotshme që ka të bëjë lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën 2013 – 2016.

Për më shumë detaje ia jap fjalën relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Atëherë, faleminderit!

Po ju paraqes në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit, në kushtet kur të gjithë jeni njohur me raportin.

Po kaloj direkt në vlerësimin për katër kriteret dhe konkretisht për kriterin “Aftësitë profesionale të ndihmësmagjistrates”.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për sa i përket treguesit të parë, rezulton se ndihmësmagjistratja ka shfaqur aftësi shumë të mira

për identifikimin e qartë, konciz, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes, paraqitjen e tyre në mënyrë të integruar me provat e administruara, pasqyrimin e ecurisë procedurale të çështjes në gjykatat e faktit, duke integruar në këtë pjesë të relacioneve arsytet thelbësore, etj. Sa i përket identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në rastin konkret, në aktet e analizuara referohet norma procedurale penale/civile në lidhje me shkaqet e rekursit dhe mungesën e elementeve, etj.

Sa i përket këtij treguesi, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës është “shumë e lartë” dhe për këtë është propozuar pikëzimi i saj me 25 pikë.

Sa i përket “Aftësisë për të interpretuar ligjin”, në konkluzion, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se znj. {...}, ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural dhe atyre çështjeve në zgjidhjen e themelit të çështjes. Evidentohet kujdesi i saj për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, të Gjykatës së Lartë dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës.

Sa i përket këtij kriteri, vlerësohet se aftësia për këtë tregues është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

Sa i përket treguesit “Arsyetimi ligjor”, në konkluzion, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se ndihmësmagjistratja tregon kujdes të posaçëm për pasqyrimin qartë, konciz dhe të saktë të fakteve të çështjes, ecurisë procedurale të gjykimit, shkaqeve të rekursit dhe në arsyetimin ligjor të saj. Në pjesën e mendimit të ndihmësit ligjor, rezulton e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të koncizitetit dhe kuptueshmërisë të mendimit të ndihmësit ligjor lidhur me zgjidhjen e çështjes apo evidentimin e çështjeve për diskutim para Kolegjit. Edhe në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin.

Për sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës është vlerësuar shumë e lartë, duke u propozuar vlerësimi i saj me 15 pikë.

Sa i përket “Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar”, evidentohet që ndihmësmagjistratja, si në relacionet ashtu edhe në vendimet gjyqësore, ndjek një strukturë të mirëpërcaktuar dhe vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë, i ka të ndara me tituj por edhe në paragrafë të cilat e ndihmojnë lexuesin.

Për sa më sipër, vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, në tërësi, në dokumentet e analizuara dhe shkalla e argumentimit pavarësisht se në masë të ndryshme, kushtëzuar nga natyra komplekse ose jo, rezulton aftësi e lartë e saj. Evidentohet aftësia e ndihmësmagjistrates për të ekstraktuar dhe analizuar aspektet thelbësore në lidhje me shkaqet e ngritura në rekurs si dhe dhënia e argumenteve të plota dhe koncize lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural mbi këto fakte si dhe aftësia e saj për të evidentuar çështjet ligjore që duhet të vlerësohen nga Kolegji. Duke analizuar të gjithë metodologjinë e punës së ndihmësmagjistrates, e vlerësuar kjo me mendimin e kolegjit për vlerësimin e punës së saj në hartimin e projektvendimeve, vlerësohet se aftësia e saj është “shumë e lartë”. Për këtë arsye, propozohet pikëzimi i saj me 25 pikë.

Kështu, propozimi për kriterin e parë “Aftësia profesionale e ndihmësmagjistrates” është "Shkëlqyeshëm", duke e pikëzuar me 100 pikë.

Sa i përket kriterin “Aftësia organizative e ndihmësmagjistrates”, konkretisht për “Treguesin sasior në përfundimin e dokumenteve”, nga burimet e vlerësimit, pasi janë analizuar të dhënat statistikore të cilat janë pjesë e dosjes së rivlerësimit ashtu edhe të dhënat statistikore të marra rishtazi nga ana jonë, në kushtet kur kanë rezultuar të dhënave të ndryshme sa i përket atyre të paracaktuara nga vlerësimet e kolegjeve është vlerësuar se në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, ndihmësmagjistratja ka përgatitur për relativ mesatarisht 22 çështje në muaj, duke tejkalluar me 2 çështje në muaj ose me 10% standardin sasior në fuqi prej 20 çështjesh.

Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë.

Sa i përket “Rendimenti i përfundimit të çështjeve”, duke pasur parasysh se nuk kemi të dhëna, por marrim parasysh sa çështje duhet të shqyrtonte në muaj, ka rezultuar se duhet të shqyrtonte rreth 20 çështje në muaj. Mesatarisht për periudhën që ajo ka punuar rreth 25 muaj, duhet t’i jenë caktuar 500 çështje, në fakt asaj i janë caktuar dhe ka relatuar 543,5 çështje që kanë përfunduar me vendim dhe 16 çështje referuar atyre të vlerësimit të kolegjit, duke tejkalluar kështu standardin sasior. Për sa më sipër ndihmësmagjistratja duhet të pikëzohet me pikët maksimale edhe për këtë kriter.

Sa i përket “Aftësisë për të përfunduar në kohë çështjet e caktuara”, nga burimet e vlerësimit nuk ka të dhëna për sa i përket relacioneve.

Burim vlerësimi janë dhe dy vendimet e zgjedhura nga ndihmësmagjistratja, ku rezultojnë se kanë përfunduar brenda standardit të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish-KLD-së, prej 4 dhe 6 muajsh.

Sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë nëntregues vlerësohet shumë e lartë dhe propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

Sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje të përgatitur”, referuar të dhënave lidhur me këtë tregues, në mungesë të standardeve minimale kohore të miratuara brenda të cilave duhet të përgatitej dokumenti ligjor si dhe pamundësisë objektive të përlogaritjes së kohës mesatare të përgatitjes së relacioneve për 12 çështjet e analizuara, vlerësohet se aftësia e ndihmësmagjistrates në këtë tregues është shumë e lartë dhe pikëzohet me 20 pikë.

Sa i përket “Aftësisë për të evidentuar dhe kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të organizimit të procesit gjyqësor”, referuar 12 relacioneve, në mungesë të të dhënave konkrete lidhur me veprimet procedurale të kryera nga ndihmësmagjistratja në drejtim të efektivitetit dhe produktivitetit në funksion të organizimit të procesit gjyqësor për zgjidhjen e çështjes, vlerësohet se aftësitë e saj është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Aftësia për të evidentuar brenda çështjeve të caktuara për relacionim, ato që kërkojnë vëmendje të posaçme dhe që duhet të trajtohen me përparësi”, nga 12 çështjet që janë zgjedhur me short, nuk rezulton që të kenë afate për përfundimin e tyre. Sa më sipër, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet maksimalisht, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket treguesit “Rregullshmëria, saktësia e plotësia e dosjes”, në tërësi, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se aktet e dosjes gjyqësore janë në çdo rast të rregullta, të sakta dhe të plota, duke përfshirë edhe relacionin e hartuar nga ndihmësi ligjor dhe çdo akt që i përket fashikullit të Gjykatës së Lartë. Shkalla e kujdesit të ndihmësmagjistrates është e lartë si në drejtim të përmbajtjes së fashikullit, të renditjes së akteve të dosjes dhe të materialeve të tjera me qëllim që dosja të jetë lehtësisht e

shfrytëzueshme. Sa më sipër vlerësohet se shkalla e aftësisë së saj është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit sa i përket kriterit “Aftësia organizative e ndihmësmagjistrates” është "Shkëlqyeshëm" me 100 pikë.

Sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, në tërësi në të gjithë këtë kriter është vlerësuar "Shkëlqyeshëm", pasi nuk ka të dhëna që gjyqtarja të mos ketë respektuar etikën në punë, paanshmërinë, etj.

Sa i përket kriterit të fundit...

Harrova të them që gjyqtarja është njohur me projektraportin dhe nuk ka paraqitur kundërshtime. Vetëm ka paraqitur një provë e cila i shtohet provave të cilat ndodhen në dosje, sa i përket angazhimit të saj në kryerjen në veprimtari ndërinstitucionale dhe për kryerjen e veprimeve të cilat i ngarkohen nga organet drejtuese.

Për këtë kriter kanë rezultuar të dhëna si për ushtrimin në veprimtari ndërinstitucionale, duke qenë se zonja {...} ishte angazhuar si pedagoge e jashtme në Universitetin e Tiranës në periudhën 2013 – 2014, si dhe ka qenë anëtare e Unionit të Gjyqtarëve dhe ka hartuar sugjerime sa i përket ndryshimeve të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”.

Për sa i përket “Publikimeve ligjore”, nuk rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit të ketë publikime. Rezultojnë dy publikime, por i përkasin periudhës 2012, e cila është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, për këtë arsye nuk është vlerësuar për këtë kriter, duke e pikëzuar me 0 pikë.

Në këto kushte, propozimi për sa i përket kriterit të katërt është 93 pikë.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është "Shkëlqyeshëm" me 393 pikë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin e projektraportit sipas propozimit të relatores?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Me kaq po e mbylлим mbledhjen e sotshme.

Mirë u takofshim!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor